



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.34.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
RANILLUGUT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Ranillugut, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i Ekipit- Faik Thaçi, si dhe Anëtarët Milosh Petrovic dhe Ejup Simnica, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Mujë Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	18
5 Qeverisja e mirë.....	19
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	21
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	24
Shtojca III: Letër konfirmimi	29

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Ranillugut për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 03/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Ranillugut.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.


Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Më gjërsisht shih Pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe shërbimit të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Ranillugut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Ranillugut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Ranillugut është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme , si dhe është përgjegjës për

kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime). Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Ranillugut.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna e Ranillugut kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Nëse PFV janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
- Nëse Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar me kohë; dhe
- Nëse komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek MF.

Në kontekst të PFV-ve është bërë një gabim, tek neni 14, Raporti i ekzekutimit të buxhetit, të hyrat vetjake ishin mbivlerësuar për vlerën 4,631€, si rezultat i prezantimit të gabuar si të hyrave indirekte (gjobave nga policia në vlerë 2,021€ dhe gjobave nga agjensioni i pyjeve në vlerë 2,610€).

Inkurajojmë menaxhmentin që në PFV-të e vitit 2018 të mos e përsëritin këtë gabim.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime për PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi i projekteve kapitale vazhdon të mbetet fusha më shqetësuese, duke rezultuar në vonesa në përfundim të projekteve si dhe ndërprerjen e tyre. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, veçanërisht rreth rregullsisë në menaxhimin e tyre. Gjithashtu kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të siguruar rregullsinë në menaxhimin e shpenzimeve.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit për investime kapitale, listës së pagave, procesi i prokurimit rreth menaxhimit të kontratave si dhe llogarive të arkëtueshme.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e planifikuara dhe arkëtuara sipas kategorive ekonomike, duke i paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,676,765	1,851,845	1,548,080	1,350,528	1,273,953
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,563,431	1,561,336	1,436,195	1,293,476	1,143,139
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	137,905	51,615	35,764	68,135
Të hyrat vetjake ³	113,334	113,334	23,423	21,288	62,679
Donacionet e jashtme	-	39,270	36,847	-	-

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 175,080€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 137,905€ dhe donacionit në vlerë 39,270€.

Në vitin 2017, Komuna ka shpenzuar 84% të buxhetit final ose 1,548,080€, me rënie krahasuar më vitin 2016 për 6%. Realizimi i buxhetit vazhdon të mbetet në nivel jo të kënaqshëm, e kryesisht të investimet kapitale i cili ishte në nivel të ulët, në 60%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,676,765	1,851,845	1,548,080	1,350,528	1,273,953
Pagat dhe Mëditjet	984,810	982,715	975,774	982,112	971,792
Mallrat dhe Shërbimet	131,125	171,286	132,683	139,774	124,205
Shërbimet komunale	20,000	31,547	26,730	24,990	28,055
Subvencionet dhe Transferet	36,994	51,994	46,021	51,732	46,836
Investimet Kapitale	503,836	614,303	366,872	151,920	103,065

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 40,161€, nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak. Megjithatë edhe përpos rritjes së buxhetit shpenzimet ishin në nivel të ulët, në 77%. Gjithashtu buxheti final të shërbimet komunale ishte rritur për 11,547€, nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak, derisa është realizuar në nivelin 85%;
- Te subvencionet dhe transferet, buxheti final është rritur 15,000€ nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak. Realizimi në këtë kategori ishte relativisht i mirë në 89%; dhe
- Te investimet kapitale buxheti final ishte rritur për 110,467€ ose rreth 22%, ishte si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 70,497€, si dhe granteve nga donatorët në vlerë 39,970€. Megjithatë edhe përpos rritjes së buxhetit niveli i realizimit ishte shumë i ulët, në vetëm 60%.

Çështja 1 - Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale

E gjetura Komuna nuk ka arritë të realizojë buxhetin për investime kapitale sipas planit dhe projekteve të synuara. Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit në vlerë prej 110,467€, vetëm 60% e ishte shpenzuar. Kjo ka shkaktuar një ulje të performancës ndaj shpenzimeve në total.

Ekzekutimi i ulët lidhur me projektet kapitale vazhdon të mbetet është sfida kryesore me të cilën po përballet komuna. Shkaktarë të ekzekutimit të ulët janë vonesat në realizim të kontratave dhe ndërprerja e njëanshme e kontratave nga operatorët ekonomik.

Rreziku Ekzekutimi i ulët i buxhetit redukton efektivitetin e planeve vjetore të organizatës. Mos-përmbushja e programit për investime kapitale do të rezultojë në realizimin e më pak projekteve, e kjo do të ndikojë në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të sigurojë se ka ndërmarrë një vlerësim sistematik të shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.

3.2 Të hyrat

Komuna ka planifikuar të inkasoj të hyra vetjake në vlerë 113,334€, ndërsa gjatë vitit kishte realizuar 96,001€, apo në shkallën 85% të planifikimit. Krahasuar me vitet e më hershme ka një trend të rënies së inkasimit të tyre. Të hyrat vetjake kryesisht përbëhen nga: tatimi në pronë, taksat e ndryshme administrative, ndarja e pronave dhe nga shërbimi për mbledhjen e mbeturinave.

Në strukturën buxhetore, të hyrat vetjake marrin pjesë me rreth 7%.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	113,334	113,334	96,001	145,069	112,334
Totali	113,334	113,334	96,001	145,069	112,334

Në raport me vitin 2016, inkasimi i të hyrave ka pësuar një rënie prej 66% apo në vlerë 49,068€. Kjo rënie vjen si rezultat i mos aplikimit të ligjit të faljeve të borxheve në gjysmën e dytë të vitit 2017, rezultat i të cilit në vitin 2016 qytetarët kanë paguar në masë më të madhe.

Çështja 2 - Mos regjistrimi i duhur i te hyrave nga taksa e veprimtarisë

- E gjetura** Komuna ka planifikuar të hyra nga taksa e veprimtarisë në vlerë 20,085€, ndersa janë realizuar 12,943€ apo 64% të planifikimit. Megjithate komuna gjatë evidentimit të tyre ka gabuar ne regjistrim në librin kryesor, duke i regjistruar si “taksa tjera administrative” në kodin 50019, derisa kodi adekuat sipas planit kontabel ishte “taksa te veprimtarisë” në kodin 50029.
- Rreziku** Regjistrimi i të hyrave në librin kryesor me kode jo adekuate sjell deri të rreziku i pasqyrimin jo të drejtë të të hyrave sipas llojit dhe zvoglon mundësin për analiza të mirfillta, si dhe vështirëson harmonizimin e të dhënave dhe raportimin financiar.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të siguroj se të hyrat klasifikohen dhe regjistrohen ne kode adekuate me rastin e regjistrimit të tyre, sipas planit kontabël të vitit aktual të aprovuar nga thesari.

3.3 Pagat dhe shtesat

Komuna, me buxhetit fillestar për paga dhe mëditje kishte planifikuar shumën prej 984,167€. Buxheti final ishte pothuajse i njëjtë me buxhetin fillestar, ndërsa shpenzimet ishin 975,774€ apo shprehur në përqindje 99%.

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar që menaxhohet nga MF. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve shoqëruese, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin më thesar.

Në buxhetin total të komunës pagat marrin pjesë me 63% të shpenzimeve.

Çështja 3 - Dobësi në menaxhimin e listave të pagave

E gjetura Në listat e pagave duhet të përfshihen vetëm personat të cilët aktualisht punojnë në institucionet përkatëse. Të Komuna e Ranillugut, ekziston pa pajtueshmëri ne mes listës së pagave të shkollave fillore dhe stafit te angazhuar.

Ne testuam listat e pagave të dy shkollave fillore të komunës, dhe vërejtëm se në listat e pagave janë të përfshirë edhe të punësuar në institucione tjera të komunës, si:

- Në një shkollë fillore nga 39 të punësuar të përfshirë në listën e pagave, pesë nga ta janë roje në ndërtesat e komunës, tre ishin profesor që punojnë në shkollën e mesme të mjekësisë dhe dy pastrues që punojnë në institucione parashkollore; dhe

- Në një shkollë tjetër fillore nga 53 të punësuar të përfshirë në listën e pagave, dy janë punëtor sigurimi në objekte të komunës, dy janë zyrtarë të komunës dhe një punon në shkollë të mesme.

Po ashtu si pasojë e mos ndarjes së orëve të mësimi sipas normave të miratuara, një pjesë e të punësuarve nuk po arrijnë të kenë normën e plotë të mësimi.

Rreziku

Përfshirja e stafit nga sektorët tjerë në listat e pagave paraqet paqartësi dhe menaxhmenti i komunës nuk ka informata të plota lidhur me personelin e saj, si dhe e vënë në pikëpyetje ndarjen e buxhetit. Ndarja e normave të orëve në arsim është në kundërshtim me ligjin dhe dispozitat në fuqi.

Rekomandimi 3

Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet janë shqyrtuar, dizajnuar dhe vendosur në të gjitha nivelet drejtuese lidhur me fushat e pagave, dhe të sigurojë që të pastrohen listë pagat e shkollave nga stafi që nuk janë të punësuar në shkollë, si dhe të shqyrtojë mundësinë e mos ndarjes së normave në sistemin arsimor.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti fillestar për mallra dhe shërbime, si dhe shërbime komunale për vitin 2017 ishte 151,125€, mirëpo me rishikim ishte rritur për 51,708€ duke arritur në 202,833€. Gjatë vitit 2017 kishte shpenzuar 159,413€ apo 79% të buxhetit. Mallrat dhe shërbimet në buxhetin final të komunës marrin pjesë me 11%. Kontrollet e zbatuara në mallra dhe shërbime nga komuna janë efektive për të siguruar se shpenzimet e ndodhura dhe pagesat e tyre janë në përputhje me legjislacionin.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Subvencionet dhe transferet

Subvencionet janë kategori e ndihmave financiare pa kthim të drejtpërdrejtë që u jepen përfituesve nga komuna. Subvencionet e dhëna kanë të bëjnë me përkrahjen financiare nga ana e komunës për fusha dhe aktivitete të ndryshme. Ato kryesisht u ndahen entiteteve publike dhe personave fizik në nevojë. Buxheti fillestar për kategorinë e subvencioneve për vitin 2017 ishte 36,994€, mirëpo me rishikim ishin rritur në 51,994€. Nga kjo vlerë ishin shpenzuar 46,021€, apo 89% e buxhetit. Subvencionet ishin paraparë të buxhetohen nga fondi i të hyrat vetjake të komunës. Kontrollet e zbatuara nga komuna përcaktohen me rregulloren e brendshme dhe udhëzimet e përgjithshme të shpenzimit të parasë publike.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Investimet kapitale

Komuna me buxhet fillestar kishte planifikuar të shpenzonte mjete në vlerë 503,836€ për investime kapitale. Me rishikim të buxhetit shuma ishte rritur për 110,467€ duke e rritur buxhetin final në 614,303€. Komuna nga kjo shumë kishte shpenzuar vetëm 366,872€ apo 60% të buxhetit final. Ato kanë të bëjnë me financimin e projekteve kapitale në infrastrukturë, objekteve sportive, etj.

Në strukturën e buxhetit fillestar shpenzimet kapitale marrin pjesë me 22%.

Çështja 4 - Ndërprerja e punimeve në mënyrë të njëanshme.

Sipas buxhetit fillestar, komuna kishte planifikuar ndërtimin e një salle sportive për shkolla, në vlerë 125,000€. Me datën 12/09/2017 komuna kishte shpërblyer operatorin ekonomik më të favorshëm, duke lidhur kontratë me vlerë 113,421€. Sipas kontratës projekti duhet të përfundonte me 10/12/2017. Për punët të cilat janë realizuar, komuna kishte paguar 53,013€.

Operatori ekonomik ishte vonuar në përfundimin e punëve, dhe me datë 29/12/2017 në mënyrë të njëanshme kishte ndërprerë punimet pa ndonjë arsyetim dhe pa pajtimin e menaxherit të kontratës. Përkundër kësaj komuna nuk kishte ndërmarrë hapat e duhur për të konfiskuar sigurimin e ekzekutimit, 10% të vlerës së kontratës.

Rreziku Ndërprerja e punimeve në mënyrë të njëanshme si dhe mos konfiskimi i sigurimit të ekzekutimit rrit rrezikun e mos përfundimit të punimeve sipas afatit kohor të paraparë si dhe rrit shpenzimet tjera për tenderim të ri.

Rekomandimi 4 Kryetari duhet të sigurojë se ka shtuar kontrollet në procesin e menaxhimit të kontratave, në mënyrë që punët të realizohen në përputhje të plotë me kushtet e kontraktuara. Në rastet kur pa ndonjë arsye operatori ekonomik ndërprerë kontratën, atëherë komuna duhet të konfiskojë sigurimit të ekzekutimit.

Çështja 5 - Pagesa e TVSH-së për projektet e financuara nga donatorët

E gjetura Donatorët e jashtëm me rastin e financimeve në komuna janë të liruar nga pagesat e TVSH-së, bazuar në Ligjin Nr.05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, neni 33. Këtë të drejtë ligjore komuna nuk e kishte paraparë me rastin e lidhjes së kontratave.

Në dy raste ku bashkë financues ishin donatorët, komuna kishte paguar në llogari të përfituesve vlerën e plotë të faturave duke mos zbritur vlerën e TVSH-së, si:

- Te pagesa për projektin “Rregullimi i lumit” në vlerë 15,892€, është paguar gabimisht edhe vlera e TVSH-së prej 2,424€; dhe
- Te pagesa për projektin “Rregullimi i platos” në vlerë 14,669€, gjithashtu është paguar gabimisht vlera e TVSH-së prej 2,238€.

Rreziku Pagesat e TVSH-së nga mjetet e financuara nga donatorët të cilët janë të liruar me ligjet vendore, rrit rrezikun për zvogëlim të donacioneve si dhe komuna zvogëlon mundësitë e përfitimeve maksimale nga donacioni i dhënë.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të siguroj se ka shtuar kontrollet në rastet e bashkëfinancimeve me donatorë të jashtëm, për të siguruar se pagesat bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi (Ligjin e TVSH-së). Po ashtu të kërkoj nga operatorët ekonomik të korrigjojnë faturat e tyre dhe vlerën e TVSH-së, ta kthejnë në llogari të komunës.

3.7 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Rregullorja Financiare e Thesarit 02/2013 obligon organizatat buxhetore që pasuritë jo financiare të menaxhohen sipas kësaj rregulle. Komuna ka arritur ta përfundoj regjistrimin e pasurive mbi 1,000€ në SIMFK. Pasuritë me vlerë nën 1,000€ me afat përdorimi mbi një vit duhet të mbahen në sistemin e-pasuria, por ky sistem nuk ishte në funksion për shkak të pa mundësisë në kyçje. Komuna për nevoja të saj përdor një sistem në formatin Excel i cila i ka të gjitha elementet e kërkuara rreth regjistrimit të pasurisë.

Kryetari i Komunës me kohë kishte formuar komisionin për inventarizimin e pasurive të cilët e kishin përfunduar këtë proces para përgatitjes dhe dorëzimit të PFV-ve. Vlera neto e pasurive mbi 1,000€ ishte 8,404,511€, ndërsa e pasurive nën 1,000€ në vlerë 84,940€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.8 Të arkëtueshmet

Komuna bazuar në ligjin e vetëqeverisjes lokale inkason lloje të ndryshme të të hyrave vetjake. Llogaritë e arkëtueshme të komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe organizatat i detyrohen komunës. Komuna në PVF-të e vitit 2017 ka deklaruar llogari të arkëtueshme në vlerë 289,220€.

Pjesëmarrja e tyre ishte si në vijim: tatimi në pronë në vlerë 153,930€, shitja e shërbimeve në vlerë 88,640€ dhe taksa tjera administrative në vlerë 46,650€.

Çështja 6 - Rritja e llogarive të arkëtueshme

E gjetura Përkundër rekomandimit të dhënë në vitin paraprak dhe zotimit për zbatimin e tij, edhe me tutje komuna nuk ka marrë veprimet e nevojshme për të krijuar mekanizma për të rritur inkasimin e të hyrave të faturuara. Si pasojë, të arkëtueshmet edhe me tutje janë shumë të larta, ose në nivel më të lartë në raport me vitin paraprak për 35,360€.

Rreziku Mungesa e masave konkrete për të inkasuar llogaritë e arkëtueshme vazhdon të rezultojë në nivele të larta të tyre dhe rrjedhimisht edhe me reduktimin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunës. Gjithashtu, kjo redukton edhe fleksibilitetin e komunës ndaj shpenzimeve të planifikuara që financohen nga të hyrat vetjake.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për inkasimin e të hyrave të saj, përfshirë edhe të arkëtueshmet e mbetura nga vitet paraprake. Fillimisht duhen të shfrytëzohen të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të komunës, me pas të shfrytëzoj edhe masat tjera ligjore për të siguruar inkasimin e tyre.

3.9 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj kreditorëve në PVF-të e vitit 2017 ishte 3,830€. Këto janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Obligimet e pa paguara janë të natyrës së shpenzimeve postare, mirëmbajtjes së veturave dhe drekave zyrtare. Këto obligime kishin mbetur pa u paguar për shkak se janë krijuar në fund të vitit 2017.

Komuna zbaton një proces të rregullt të raportimit të obligimeve.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 të Komunës së Ranillugut ka rezultuar në 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur më kohë Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra dhe koha se si do të zbatohen rekomandimet e dhëna në raport.

Deri në fund të auditimit për vitin 2017, shtatë rekomandime ishin zbatuar, dy ishin në proces të zbatimit dhe katër nuk janë adresuar.

Po ashtu nga raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 ishin bartur edhe pesë rekomandime për tu zbatuar në vitin 2017, nga të cilat tri janë në proces të zbatimit dhe dy kanë mbetur të pa zbatuara.

Çështja 7 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Përkundër progresit të theksuar nga komuna në zbatimin e rekomandimeve, ende një pjesë e tyre, përfshirë edhe rekomandimet e dhëna në vitet e mëhershme kishin mbetur të pa zbatuara ose në proces të zbatimit. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna do të ndikonte në eliminimin e dobësive në kontrollet e menaxhmentit, të cilat janë përsëritë edhe këtë vit.

Moszbatimi i rekomandimeve në vazhdimësi ka rezultuar në dobësitë e paraqitura si në vijim:

- Realizimi i ulët i buxhetit për investimet kapitale;
- Mos regjistrimi i saktë i të hyrave vetjake;
- Realizimi i ulët i të arkëtueshmeve; dhe
- Themelimi i komitetit të auditimit.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të dhëna në vitin e kaluar dhe viteve të mëhershme shpie deri të rreziku i pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta si dhe mundësisë së përsëritjes së gabimeve.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Për komunën, aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve dhe qeverisjen e mirë me pasuritë komunale.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Komuna ka dorëzuar pyetësorin e vet-vlerësimit si dhe ka hartuar një listë të rreziqeve, kërkesë kjo e procedurës numër katër të dokumentit të Thesarit "Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli".

Edhe pse Komuna ka bërë një numër përmirësimesh në qeverisje, ende mbesin fusha ku nevojiten zhvillime të rëndësishme. Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është edhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit. Auditimi i këtij viti ka nxjerrë në pah se niveli i rekomandimeve të zbatuara nga viti i kaluar ishte akoma jo në nivelin e pritur. Komuna nuk kishte arritur t'i zbatoj në tërësi rekomandimet e vitit të kaluar, përfshirë edhe ato të viteve paraprake.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Komuna ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB), e cila operon me vetëm një auditor i cili njëkohësisht është edhe drejtor i njësisë. NJAB kishte përgatitë planin strategjik tre vjeçar (2017-2019) si dhe planin vjetor të auditimit për vitin 2017 i cili është aprovuar nga menaxhmenti i komunës. NJAB, për vitin 2017 kishte planifikuar të kryej pesë auditime duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut si dhe përcaktimin e prioriteteve. Plani i aprovuar ishte përmbushur nga NJAB duke finalizuar të pesë auditimet.

Po ashtu NJAB kishte planifikuar një auditim për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit.

Çështja 8 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve dhe mos themelimi i komitetit të auditimit

E gjetura Nga gjithsej 11 rekomandimet e dhëna, gjashtë ishin zbatuar plotësisht, katër ishin në proces të zbatimit, ndërsa një ka mbetur i pazbatuar. Moszbatimi i plotë rekomandimeve tregon një mungesë të vullnetit të menaxhmentit për marrjen e përfitimeve nga auditimi i brendshëm dhe sigurisë mbi funksionimin e kontrolleve të brendshme.

Ndikimi i produkteve të auditimit të brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja sistematike e një Komiteti efektiv të Auditimit. Komiteti i auditimit (KA) e fuqizon rolin e auditimit të brendshëm duke siguruar një pavarësi më të madhe për auditorin e brendshëm. Komuna nuk e ka të themeluar KA-në.

Rreziku Njëherit, moszbatimi i rekomandimeve nga menaxhmenti redukton efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe përsëritjen e dobësive të identifikuara. Mos themelimi i KA-së, tregon se menaxhmenti nuk i ka dhënë rëndësi të duhur një sistemi të kompletuar të auditimit të brendshëm, e cila mund të dëmtojë pavarësinë e NJAB-së.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet marrë të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese. Përveç kësaj ne sugjerojmë edhe themelimin/funksionimin e KA-së, që t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar kontrolle të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Komuna ka raporte të rregullta tre mujore, gjashtë mujore, nëntë mujore dhe raportin vjetor të cilat i prezanton në Asamblenë Komunale. Ndërsa sa i përket raportimit të brendshëm, ka raportime të rregullta mujore në mënyrë formale në bordin e drejtorëve.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara nuk janë mjaft efektive dhe ato duhet të përmirësohen kryesisht menaxhimin e buxhetit për investime kapitale, në fushën e regjistrimit të hyrave sipas kodeve adekuate, menaxhimin të listës së pagave dhe llogarive të arkëtueshme. Ne inkurajomë menaxhmentin t'i forcojë edhe me tutje kontrollet për të përmirësuar menaxhimin në fushat e lartcekura.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të themelojë Komitetin e Auditimit i cili duhet të jetë një nga faktorët që fuqizojnë rolin dhe mbikëqyrjen e auditimit të brendshëm. Adresimit të rekomandimeve të NJAB duhet t'i kushtohet rëndësi më e madhe.		NjAB kishte arritur ta përmbushë plotësisht planin e auditimit, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve ishte i ulët. Me tutje ende nuk është themeluar KA.	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore monitorohet në mënyrë formale dhe sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.			Nuk janë marrë masa.
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari duhet t'i forcojë kontrollet në planifikimin dhe menaxhimin e orëve dhe punonjësve në arsim për të siguruar një ndarje të tyre në përputhje me nevojat reale dhe kufizimet buxhetore. Kryetari duhet ta iniciojë një rishikim të dosjeve të personelit mjekësor për të konfirmuar që të gjithë punonjësit paguhen në bazë të përshkrimit të vendit të punës të mbështetur me dëshmitë relevante. Po ashtu, duhet të sigurojë respektim të plotë të rregullave të rekrutimit dhe ta rishqyrtojë sistemimin e punëtorëve të sigurimit në kuadër të stafit komunal.		Dosjet e personelit janë kompletuar, mirëpo ende nuk janë përmirësuar listat e pagave dhe normat e punës së të punësuarve.	

3.6 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari duhet të analizojë shkaqet për mos zbatimin e rregullave financiare për menaxhimin e të hyrave vetjake. Kontrollat duhet të forcohen dhe të gjitha departamentet duhet të kryejnë harmonizimet në kohë për të siguruar që të gjitha të hyrat vetjake janë të plota dhe prezantohen saktë në PVF. Procesi i planifikimit duhet të sigurojë identifikim të të gjitha burimeve të të hyrave vetjake dhe vendosjen e tyre në buxhetin e komunës.		Pjesërisht, harmonizimet bëhen, mirepo ende ka regjistrime në kodet jo adekuate.	
3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet të përgatitë një strategji realiste me udhëzime të qarta dhe afate të caktuara për mbledhjen e borxheve të vjetra. Po ashtu, duhet të vendosen kontrole efektive për mbledhjen e të hyrave, e që do parandalonte rritjen e llogarive të arkëtueshme. Kryetari nuk duhet të mjaftohet me inkasimet aktuale dhe të injorojë mbledhjen e borxheve të vjetra.			Nuk janë marrë masa.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së Opinionit. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i evituar gabimet në paraqitjen jo të plotë të llogarive të arkëtueshme. Gjithashtu, duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Po		

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë se plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve ende të pa zbatuara specifikon qartë masat dhe veprimet e nevojshme për të korrigjuar dobësitë dhe mangësitë e identifikuar. Përparësi në trajtimin e rekomandimeve duhet të kenë çështjet që konsiderohen më të rëndësishme dhe që përmbajnë nivel më të lartë rreziku.			Nuk janë marrë masa.
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se janë hartuar strategjia për zhvillim dhe regjistri i rreziqeve. Pas hartimit të këtyre dokumenteve, të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë tek persona kyç për menaxhimin dhe monitorimin e tyre, dhe të kërkojë raporte në baza të rregullta mbi implementimin e tyre.	Po		
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbejë si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.	Po		
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme gjatë muajve në vijim.	Po		

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit për investimet kapitalet dhe mos shfrytëzimin e të hyrave vetjake duke shtuar kontrollet në realizimin e buxhetit si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në 2017. Po ashtu, duhet të sigurojë se planifikimi për kategorinë e pagave dhe mëditjeve të jetë i bazuar në nevoja reale.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi të jetë i bazuar në të dhëna reale dhe pritshmërinë për realizim, të sigurojë se harmonizimi mes departamenteve bëhet sipas kërkesave të Thesarit dhe se vlerat më të mëdha se 10€ paguhen përmes llogarisë bankare të autorizuar nga thesari.		Harmonizimi ne mes te departamenteve është zbatuar, mirëpo ende bëhen pagesa mbi 10€ në para të gatshme.	
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet janë shqyrtuar, dizajnuar dhe vendosur në të gjitha nivelet drejtuese lidhur me fushat e pagave, dhe të sigurojë që dosjet e personelit duhet të plotësohen me të gjitha kërkesat kryesore që kërkohen me rregullore, si dhe të shqyrtojë mundësinë e mos ndarjes së normave në sistemin arsimor.		Dosjet e personelit janë kompletuar, mirëpo ende nuk janë përmirësuar listat e pagave dhe normat e punës së të punësuarve.	
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, shërbimet komunale	Kryetari duhet ta shqyrtojë pse kërkesat ligjore nuk janë përmbushur në këto raste dhe të shtojë kontrollet për të siguruar se situata të tilla nuk do të përsëriten dhe janë respektuar të gjitha kërkesat e legjislacionit në fuqi.	Po		

3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet t'i rishikojë kontrollet mbi ndarjen e subvencioneve për të siguruar zbatim të plotë të rregullores së brendshme dhe monitorim efektiv të shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës për të siguruar arritjen e objektivave të synuara, dhe rastet e tilla, në të ardhmen nuk duhet të përsëriten.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari i Komunës duhet të ndërmerr masa të menjëhershme duke forcuar kontrollet për të siguruar shpenzimin e buxhetit sipas rrjedhës së parasë së gatshme, të ndaloj dhënien e avanseve mbi shumat e lejuara dhe të sigurojë se regjistrimet bëhen në kodet adekuate, për të parandaluar mbivlerësimin e pasurisë.			Nuk janë marrë masa.
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë sa më parë që është azhurnuar regjistri i pasurive, me gjithë pasurinë në pronësi të komunës, duke larguar pasurinë të cilën nuk e ka në posedim dhe nuk e ka në pronësi të vetën. Po ashtu, të bëjë përpjekje për të përdorur sistemin e e-pasurisë.	Po		
3.2.2 Te arkëtueshmet	Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike çështjen e realizimit të të hyrave, për të siguruar se janë vendosur mekanizma efektiv për reduktimin e këtyre borxheve si dhe të propozohen veprimet konkrete për mbledhjen e këtyre borxheve duke përfshirë ushtrimin e masave administrative.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letër konfirmimi

 <p>Republika e Kosovës Komuna e Ranillugut Municipality of Ranilug</p>	 <p>Opština Ranilug Republika Kosovo Republic of Kosov</p>
<p>LETËR E KONFIRMIMIT</p> <p>Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve</p> <p>Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit</p> <p>Të nderuar,</p> <p>Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Ranillugut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”); • pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe • brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre. 	
<p>z. Vladica Aritonovic</p> <p>Kryetar i Komunës së Ranillugut</p> <p>Data: 29.Maj.2018, Ranillug,</p>	
	



 Republika e Kosovës - Република Косово - Republika Kosovo
 NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - ЗНЦР - NATIONAL AUDIT OFFICE
 ПРИЈЕМАЊА КАНЦЕЛАРИЈА - ЗНЦР Р РАНИЛУГ



Org. kod / m.k. / Org. unit: *01*

Pr. s. / Nr. / No. p. *01-336* / m. / No. / *2018*

Datum / Data / Date *29.05.2018*

СИЛНИНА РАНИЛУГ - КОМУНА Е РАНИЛУГУТ